



**UNIVERSITETI PUBLIK "KADRI ZEKA" UNIVERSITY**  
**Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë**  
**www.uni-gjilan.net tel: 0280390112**

---

Këshilli Drejtues: Tech. Dr. Ilir Gjinolli, Kryesues i KD Ref.nr.02/ 2802 datë 20/11/2024

---

Këshilli Drejtues i Universitetit Publik "Kadri Zeka" në Gjilan, në mbledhjen e -I- të mbajtur më datë 06.11.2024, mori vendim të shpall:

### **KONKURS**

**Për ndarjen e bursave universitare për nivelin baçelor dhe master për vitin akademik 2023/24**

**I. Të drejtë aplikimi për bursë universitare kanë studentët e nivelit baçelor dhe master të cilët i plotësojnë këto kushte:**

1. Të jenë studentë të rregullt;
2. Të jenë studentë të vitit të dytë e më lartë;
3. Të mos kenë vit të përsëritur;
4. Të kenë të përfunduara të gjitha provimet e vitit paraprak të studimeve në afatin e shtatorit dy.

**II. Studentët duhet plotësuar edhe kriteret shtesë të aprovuara nga KD dhe atë:**

- Studentët e Fakultetit të Edukimit, Fakultetit Ekonomik dhe Fakulteti Juridik si dhe programi master E-Qeverisje dhe SKIA duhet të kenë notën mesatare së paku 9.00;
- Studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike duhet të kenë notën mesatare më së paku 8.50.
- Studentët me notë mesatare 9.5 e mbi në Fakultetin e Edukimit, Ekonomik, Juridik dhe programet master E-Qeverisje dhe SKIA si dhe studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike me notë mesatare 9.00 e mbi do të jenë përfitues të shumës **3,000.00** euro e cila ndahet në mënyrë proporcionale për rezultate larta akademike.

**III. Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më 06.11.2024 e ka përcaktuar shumën e bursës në vlerë prej: 1,000.00 euro.**



**IV. Studentët të cilët i plotësojnë kushtet nga pika I dhe pika II e konkursit duhet të paraqesin këto dokumente:**

- Formularin e plotësuar (shkarkohet nga ueb faqja zyrtare e universitetit);
- Letërnjoftimin kopje;
- Vërtetimin e llogarisë bankare.

**V. Afatet e konkursit**

- Aplikimi për bursë universitare bëhet nga datat **21.11.2024** deri më **26.11.2024** ora 15:00.
- Dorëzimi i dokumenteve bëhet në fakultetin përkatës.

